



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE

UDHËZIM

Nr. 1, datë 11.4.2017

**“PËR ZBATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË FREKUENCAVE PËR LIRIMIN
EFEKTIV TË FREKUENCAVE TË DIVIDENTIT DIXHITAL NGA TRANSMETIMET
AUDIOVIZIVE”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 4 të nenit 5 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 22 të ligjit nr. 97, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe për zbatimin e VKM-së nr. 277, datë 29.3.2017, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”

UDHËZOJ:

Marrjen e masave për zbatimin e VKM-së nr. 277, datë 29.3.2017, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”, për lirim të plotë brenda datës 30.6.2017 të brezit 790-862 MHz (Dividenti i parë Numerik DD1) nga përdorimet për transmetime audiovizive dhe disponimin e tij nga AKEP si administrator, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi, si më poshtë:

1. AMA dhe AKEP të ngrenë një grup të përbashkët pune me përbërje të dakordësuar midis tyre, për monitorimin e procesit të lirim të DD1 nga transmetimet audiovizive në të gjithë territorin e vendit.
2. AMA dhe AKEP të hartojnë një plan të përbashkët të monitorimeve që do kryhen në terren. Monitorimi të realizohet me mjetet, aparaturat dhe ekspertizën që disponojnë AMA dhe AKEP.
3. Të njoftohen sipërmarrësit që kanë shfaqur interes në procesin e këshillimit publik të kryer nga AKEP për Dokumentin: “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (790-862 MHz)”, për fillimin e procesit të monitorimit sipas këtij Udhëzimi.
4. Grupi i punës të përfundojë misionin kur garantohej për lirim të plotë të brezit 790-862 MHz (DD1) nga përdorimet për transmetimet audiovizive brenda datës 30.6.2017.

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Këshilli i Ministrave

Tel: +355 4 2277355

E-mail: info@inovacioni.gov.al

5. Në përfundim të procesit, AMA dhe AKEP mbajnë një akt të përbashkët me rezultatet e monitorimit dhe informojnë me shkrim ministrin për përfundimin e procesit të lirimit të frekuencave të DDI nga transmetimet audiovizive.

6. Ngarkohet AMA dhe AKEP për zbatimin e këtij Udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR

Milena HARITO



Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave

Tel: +355 4 2277355

E-mail: info@inovacioni.gov.al

RELACION SHPJEGUES
PËR UDHËZIMIN PËR ZBATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË
FREKUENCAVE PËR LIRIMIN EFEKTIV TË FREKUENCAVE TË
DIVIDENTIT DIXHITAL NGA TRANSMETIMET AUDIOVIZIVE

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektakti ka për qëllim përcaktimin e masave për lirimin efektiv të frekuencave të brezit 790-862 MHz (Dividenti Dixhital 1) nga transmetimet audiovizive brenda datës 30.6.2017. Udhëzimi synon plotësimin e kuadrit nënligjor që del i nevojshëm me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 277, datë 29.3.2017 "Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave" për detajimin e masave deri në kalimin e plotë në administrim të AKEP të frekuencave të brezit 790-862 MHz (Dividenti Dixhital 1).

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektakti nuk është parashikuar në programin analitik të akteve për vitin 2017 por është plotësim i nevojshëm i kuadrit nënligjor në zbatim të ligjit Nr. 9918 datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe Planit të ri Kombëtar të Frekuencave, në veçanti për detajimin e masave që do merren nga administratorët e spektrit të frekuencave AMA dhe AKEP, deri në lirimin efektiv të frekuencave të brezit 790-862 MHz (Dividenti Dixhital 1) nga transmetimet audiovizive.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", në pikën 4, të nenit 5, ka parashikuar që ministri: "*Mund të nxjerrë urdhra dhe udhëzime me karakter normativ për çështje që lidhen me zbatimin e këtij ligji dhe politikave të zhvillimit të sektorit të komunikimeve elektronike, të miratuara nga Këshilli i Ministrave.*"

Me VKM-në Nr. 277, datë 29.3.2017, "Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave", u miratua Plani i ri Kombëtar i Frekuencave që ka parashikuar lirimin e plotë të brezit 790-862 MHz (Dividenti i parë Numerik (DD1)) nga përdorimet për transmetime audiovizive brenda datës 30.6.2017. Administrimi i

Relacion shpjegues për Udhëzimin "Për zbatimin e planit kombëtar të frekuencave për lirimin efektiv të frekuencave të dividendit dixhital nga transmetimet audiovizive"

këtij brezi kalon nga AMA tek AKEP. Aktualisht ky brez frekuencash është i okupuar për transmetime audiovizive. Për bërjen efektive të lirim të këtij brezi në datën e caktuar është e nevojshme marrja e masave nga të dy organet administruese të frekuencave për qëllime civile: AMA dhe AKEP.

Kalimi i frekuencave të DD1, nën administrimin e AKEP dhe dhënia e tij për shërbime të lëvizshme broadband është pjesë e rëndësishme e politikave të zhvillimit të sektorit dhe Planit Kombëtar të Broadband.

Ministri në rolin e politikëbërësit nxjerr këtë udhëzim me qëllim zbatimin e politikave të zhvillimit të sektorit të komunikimeve elektronike dhe përcaktimeve të miratuara me VKM nr. 277 date 29.3.2017.

Projektakti synon garantimin e lirim të brezit të DD1 përmes një procesi monitorimi në terren nga të dy organet administruese të spektrit të frekuencave civile.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti është hartuar në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës si dhe të pikës 4, të nenit 5 të ligjit Nr. 9918 date 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenit 22 të ligjit nr. 97, datë 4.3.2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe për zbatimin e VKM-së Nr. 277, datë 29.3.2017, "Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave".

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektakti nuk përfron ndonjë akt të veçantë të BE-së, por është në përputhje me rekomandimet e dhëna nga Komisioni Europian për lirin e DD1 dhe dhënien e tij në përdorim për shërbime të lëvizshme broadband.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektakti, përmban 6 pika. Në pikën e para parashikohet që AMA dhe AKEP të ngrenë një grup të përbashkët pune për monitorimin e procesit të lirim të DD1 nga transmetimet audiovizive në të gjithë territorin e vendit.

Në pikën e dytë kërkohet që të hartohet një plan i përbashkët pune për monitorimin në terren të situatës së përdorimit të këtij brezi dhe lirim të tij nga transmetimet audiovizive.

Relacion shpjegues për Udhëzimin "Për zbatimin e planit kombëtar të frekuencave për lirin efektiv të frekuencave të dividentit dixhital nga transmetimet audiovizive"

Në pikën e tretë kërkohet të njoftohen sipërmarrësit që kanë shfaqur interes në procesin e këshillimit publik të kryer nga AKEP për Dokumentin: "Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (790-862 MHz)", për fillimin e procesit të monitorimit.

Në pikën e katërt përcaktohet që grupi i punës duhet të përfundojë misionin kur garantohej për lirim të plotë të brezit 790-862 MHz (DD1) nga përdorimet për transmetimet audiovizive. Procesi duhet të kryhet brenda datës 30.6.2017.

Në pikën e pestë kërkohet raportimi tek ministri në përfundim të procesit. Ky raportim është i nevojshëm për të vijuar me proceset e tjera të rëndësishme të parashikuara në dokumentet e politikës së zhvillimit dhe legjislacionin në fuqi për komunikimet elektronike dhe lirim të frekuencave të dividentit dixhital.

Në pikën e gjashtë ngarkohet AMA dhe AKEP për zbatimin e këtij Udhëzimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektakti ngarkohen AMA dhe AKEP në cilësinë e administratoreve të spektrit civil dhe kalimin e brezit DDI nga administrimi i AMA-s tek AKEP.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar nga stafi i Ministrisë së Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektakti nuk ka ndikim në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit.

MINISTËR SHTETI PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE

MILENA HARITO



Relacion shpjegues për Udhëzimin "Për zbatimin e planit kombëtar të frekuencave për lirim efektiv të frekuencave të dividentit dixhital nga transmetimet audiovizive"